



Prishtinë, 22.03.2024
Kodi i ZRRE-së: V_1878_2024

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Rregullës Per Kushtet e Përgjithshme te Furnizimit me Energji;
- Metodologjinë e Taksave te Kyçjes të Rrjetit te shpërndarjes;
- Dëshmitë e paraqitura nga palët; dhe
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_R_2496_02_24** i dt.21.02.2024;

në seancën e mbajtur më datë 22.03.2024 nxori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET** ankesa e aplikuesit **F.K, "Solar Energy Artana SEA" SHPK** nga Komuna e Novobërdës si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi
- II. KEDS** duhet te pajisë aplikuesin me Pëlqim Elektroenergjetik si dhe Zgjidhje Teknike sipas kërkesës se aplikuesit
- III.** Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- IV.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Arsyetim

Aplikuesi F.K me datë 20.11.2023 ka paraqitur ankesë pranë DMK-së në ZRrE duke kontestuar përgjigjen e KEDS-it nr. 10130 datë 08.11.2023, me të cilën është refuzuar kërkesa e tij për dhënien Pëlqimit Elektroenergjetik dhe Zgjidhjes Teknike per kyçjen e gjeneratorit per prodhim te energjisë elektrike nga sistemi fotovoltaik me fuqi te njëkohshme Pmnj=0.495 MWp.

Bazuar në kërkesën Nr. 1123578 të datës 04.07.2023 parashtruar nga aplikuesi Alb Construction Sh.P.K Ramush Rexhep Kurti Adresa: Fshati Izvor Nr.P.n.-Novobërdë, që ka të bëjë me dhënien e pëlqimit per rregullimin e dokumentacionit teknik në KK, per ndërtimin e objektit -Panela Solure Ngastra Katsrale nr.(01513-2;01511-0;01512-0;01513-1) Z.K.Izvor, zona kadastrale P-72403028-(01513-2;01511-0;01512-0;01513-1) KEDS me datë 24.07.2023 ka lëshuar Pëlqimin Parimor me nr. 219 e ne te cilin thuhet se:



Ky pëlqim i lëshohet palës për rregullimin e dokumentacionit teknik, ndërsa për nevojë të tjera nuk guxon të përdoret dhe nuk e kushtëzon Divizionin e Shpërndarjes për furnizim me energji elektrike para se kjo të rregullohet në Pëlqim elektroenergetik;

Po ashtu konsumatori obligohet që para fillimit të ndërtimit të objektit të aplikojë për kyçje të përkohshme;

Ky pëlqim vlen 60 ditë nga data e lëshimit, brenda këtij afati obligohet konsumatori ta sjell projektin e objektit për marrjen e pëlqimit energjetik si dhe

Në parcelë ku parashihet të ndërtohet objekti nuk kemi esetë të KEDS-it.

Provë: Pëlqimi Parimor nr. 219 datë 24.07.2023

Me datë 02.08.2023 "Solar Energy Artana SEA" SHPK –F.K ka aplikuar për pëlqim elektroenergetik në KEDS për Pëlqimin Elektroenergetik për kyçjen e gjeneratorit për prodhim të energjisë elektrike nga sistemi fotovoltaik me fuqi të njëkohshme $P_{mnj}=495$ kWp si dhe ka dorëzuar projektin elektrik.

Provë: Kërkesa për PEE datë 02.08.2023

Me datë 06.09.2023 Departamenti I shërbimeve për konsumatori në KEDS, ka lëshuar informatën në të cilën thuhet se: Lidhur me kërkesën tuaj, përmes së cilës kërkoni Pëlqim Elektroenergetik nga KEDS për kyçjen e gjeneratorit për prodhim të energjisë elektrike nga sistemi fotovoltaik me fuqi të njëkohshme $P_{mnj}=0.495$ MWp, KEDS ka shqyrtuar kërkesën tuaj dhe iu informon që: Kërkesa juaj refuzohet për shkak se aktualisht kapacitetet akomoduese për gjenerim nga BRE-të në stabilimentet elektroenergetike në afërsi të lokacionit të gjeneratorit të propozuar nga ana juaj, konkretisht LP 10(20)kV Slivova i cili furnizohet nga NS 35/10kV Artana janë të plotësuara. Prandaj, KEDS nuk mund të jap kyçje për kapacitete të reja gjeneruese marrë parasysh kapacitetin pritës për BRE në këtë zonë.

Provë: Informata nr. 8675 datë 06.09.2023

Aplikuesi ka kundërshtuar informatën nr. 8675 të lëshuar nga KEDS me datë 06.09.2023 duke kërkuar që ti behet rishqyrtimi i kërkesës për Pëlqim Elektroenergetik për ndërtimin e parkut solar me kapacitet $P_{mnj}=0.495$ MWp.

Provë: Ankesa e aplikuesit datë 06.09.2023

Me datë 08.09.2023 Departamenti I shërbimeve për konsumatori në KEDS, ka lëshuar përgjigjen në të cilën thuhet se: Do të vlejnjë të dhënat me Informatën nr. 8675 të dt. 06.09.2023. Kërkesa juaj refuzohet për shkak se aktualisht kapacitetet akomoduese për gjenerim nga BRE-të në stabilimentet elektroenergetike në afërsi të lokacionit të gjeneratorit të propozuar nga ana juaj, konkretisht 35/10 kV Artana i cili furnizon linjën 10(20)kV Slivova janë të plotësuara.

Meqenëse fuqia dalëse e një njësie gjeneruese është më e madhe se kërkesa për konsum, një rritje e tensionit ndodh në zbarrat e trafostacioneve të kyçur në afërsi. Rrjedhimisht, mbritensionet dhe problemet e luhatjeve të shpejta të tensionit linden dukshëm kur sistemet fotovoltaike janë të lidhura në fund të linjës dhe në linjat me ngarkesë të ulët. Rritja e tensionit për shkak të të gjitha BRE-ve të lidhura me një linjë të TM për gjenerim maksimal dhe ngarkesë minimale tejkalohet si dhe shkaktohen devijime të tensionit të cilësisë së tensionit sipas EN50160 dhe potencialisht paraqet probleme tek konsumatorët fundorë.

Prandaj, KEDS nuk mund të jap kyçje për kapacitete të reja gjeneruese marrë parasysh kapacitetin pritës për BRE në këtë zonë.

Provë: Përgjigja e KEDS nr. 10130 datë 08.11.2023



Me datë 20.11.2023 i pakënaqur me përgjigjen e KEDS-it, aplikuesi brenda afatit ligjor paraqet ankesë pranë DMK-së në ZRRE, duke kontestuar refuzimin e kërkesës së tij nga ana e KEDS-it.

Provë: Ankesa e datës 20.11.2023

Bordi i ZRRE, duke analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e konsumatorit dhe KEDS-it, ka vërejtur se:

Bazuar në kërkesën Nr. 1123578 të datës 04.07.2023 parashtruar nga aplikuesi Alb Construction Sh.P.K Ramush Rexhep Kurti Adresa: Fshati Izvor Nr.P.n.-Novobërdë, që ka të bëjë me dhënien e pëlqimit për rregullimin e dokumentacionit teknik në KK, për ndërtimin e objektit -Panela Solure Ngastra Katsrale nr.(01513-2;01511-0;01512-0;01513-1) Z.K.Izvor, zona kadastrale P-72403028-(01513-2;01511-0;01512-0;01513-1) KEDS me datë 24.07.2023 ka lëshuar Pëlqimin Parimor me nr. 219 e ne te cilin thuhet se:

Ky pëlqim i lëshohet palës për rregullimin e dokumentacionit teknik, ndërsa për nevojën tjetër nuk guxon të përdoret dhe nuk e kushtëzon Divizionin e Shpërndarjes për furnizim me energji elektrike para se kjo të rregullohet në Pëlqim elektroenergjetik;

Po ashtu konsumatori obligohet që para fillimit të ndërtimit të objektit të aplikojë për kyçje të përkohshme;

Ky pëlqim vlen 60 ditë nga data e lëshimit, brenda këtij afati obligohet konsumatori ta sjell projektin e objektit për marrjen e pëlqimit energjetik si dhe në parcelë ku parashihet të ndërtohet objekti nuk kemi esetë të KEDS-it. Bazuar në Pëlqimin Parimor nr. 219 datë 24.07.2023, me datë 02.08.2023 "Solar Energy Artana SEA" SHPK –F.K ka aplikuar për pëlqim elektroenergjetik në KEDS për kyçjen e gjeneratorit për prodhim të energjisë elektrike nga sistemi fotovoltaik me fuqi të njëkohshme P_{mnj}=495 kWp si dhe ka dorëzuar projektin elektrik. Bordi i ZRRE bazuar në shqyrtimin e të gjithë dokumentacionit përfshi edhe Pëlqimin Parimor nr. 219 datë 24.07.2023 konstaton se aplikuesi "Solar Energy Artana SEA" SHPK –F.K me rastin e aplikimit për kyçje ka vepruar konform nenit 8 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji elektrike si dhe nenin 9 të Metodologjisë së Taksave të kyçjes së OSSH-së e ku thuhet se: "Çdo person fizik apo juridik, gjenerator/prodhues apo Konsumator Prodhues mund të aplikojë për kyçje të re apo modifikim të kyçjes ekzistuese në Sistemin e Shpërndarjes, me qëllim të furnizimit me energji elektrike apo gjenerimit të energjisë elektrike". Po ashtu në paragrafin 6 të po këtij neni thuhet se: "Në rastet e aplikimeve për kyçje të njërive gjeneruese në rrjetin e shpërndarjes, njësitë gjeneruese të BRE-ve kanë përparësi ndaj atyre konvencionale".

Me datë 06.09.2023 Departamenti I shërbimeve për konsumatorin në KEDS, ka lëshuar informatën në të cilën thuhet se: Lidhur me kërkesën tuaj, përmes së cilës kërkoni Pëlqim Elektroenergjetik nga KEDS për kyçjen e gjeneratorit për prodhim të energjisë elektrike nga sistemi fotovoltaik me fuqi të njëkohshme P_{mnj}=0.495Mwp, KEDS ka shqyrtuar kërkesën tuaj dhe iu informon se: Kërkesa juaj refuzohet për shkak se aktualisht kapacitetet akomoduese për gjenerim nga BRE-te në stabilimentet elektroenergjetike në afërsi të lokacionit të gjeneratorit të propozuar nga ana juaj, konkretisht LP 10(20)kV Slivova i cili furnizohet nga NS 35/10 kV Artana janë të plotësuar. Prandaj, KEDS nuk mund të jap kyçje për kapacitete të reja gjeneruese marrë parasysh kapacitetin pritës për BRE në këtë zonë. Pas marrjes së njoftimit, aplikuesi me datë 06.09.2023 ka kundërshtuar informatën nr. 8675 të lëshuar nga KEDS duke kërkuar që ti behet rishqyrtimi i kërkesës për Pëlqim Elektroenergjetik për ndërtimin e parkut solar me kapacitet P_{mnj}=0.495 MWp.

Me datë 08.11.2023 Departamenti I shërbimeve për konsumatorin në KEDS, në përgjigje të ankesës së aplikuesit ka lëshuar përgjigjen në të cilën thuhet se:



Lidhur me ankesën tuaj, pemës së cilës kërkoni nga KEDS rishqyrtimin e kërkesës për dhënie të Pëlqimit elektroenergjietik pas Informatës nr. 8675 të datës 06.09.2023 për kyçjen e gjeneratorit për prodhim të energjisë elektrike nga sistemi fotovoltaik me fuqi të njëkohshme $P_{mnj}=495Wp$. Për rishqyrtim të kërkesës tuaj janë marrë parasysh:

Të dhënat nga aplikimi juaj

Ankesa juaj pas informatës nga KEDS nr.8675 të dt. 06.09.2023

Analizat teknike për kyçje dhe ndikimi në rrjetin e shpërndarjes përmes DigSilent PowerFactory

Dokumentet relevante në të cilat është bazuar përgjigjja nga KEDS: Kodi I shpërndarjes dhe plani I KEDS andaj edhe do të vlejnjë të dhënat me Informatën nr. 8675 të dt. 06.09.2023. Kërkesa juaj refuzohet për shkak se aktualisht kapacitetet akomoduese për gjenerim nga BRE-të në stabilimentet elektroenergjietike në afërsi të lokacionit të gjeneratorit të propozuar nga ana juaj, konkretisht 35/10 kV Artana i cili furnizon linjën 10(20)kV Slivova janë të plotësuar.

Meqenëse fuqia dalëse e një njësie gjeneruese është më e madhe se kërkesa për konsum, një rritje e tensionit ndodh në zbarrat e trafostacioneve të kyçur në afërsi. Rrjedhimisht, mbritensionet dhe problemet e luhatjeve të shpejta të tensionit lindin dukshëm kur sistemet fotovoltaike janë të lidhur në fund të linjës dhe në linjat me ngarkesë të ulët. Rritja e tensionit për shkak të të gjitha BRE-ve të lidhura me një linjë të TM për gjenerim maksimal dhe ngarkesë minimale tejkalohet si dhe shkaktohen devijime të tensionit të cilësisë së tensionit sipas EN50160 dhe potencialisht paraqet probleme tek konsumatorët fundorë.

Prandaj, KEDS nuk mund të jap kyçje për kapacitete të reja gjeneruese marrë parasysh kapacitetin pritës për BRE në këtë zonë. KEDS ka ofruar Pëlqimin elektroenergjietik nr. 9320 të datës 09.10.2023 me të cilin vërtetohet se investitorit Sami Makolli "RIKON" SHPK i ka vazhduar afatin e PEE nr.8733 date 26.08.2022 për shkak se i njëjti nuk ka realizuar të njëjtin brenda afateve të parapara. Bazuar në të dhënat teknike të PEE nr. 9320 të datës 09.10.2023 vërtetohet se në daljen e njëjtë "Slivova" me kod 60024003 e cila furnizohet nga NS 35/10kV Artana investitorit i është lëshuar PEE për kyçjen e Gjeneratorit me prodhim të energjisë elektrike nga Energjia solare ku fuqia e instaluar e transformatorëve është $S_{inst}=1000$ kVA dhe fuqi të njëkohshme prej $P_{mnj}=800$ kW. KEDS po ashtu ka ofruar analizat teknike për rastin e kyçje s se dy gjeneratorëve përkatësisht simulimet përmes programit DigSilent PowerFactory me të cilat vërtetohet se ka luhatje të tensionit para dhe pas kyçje s se dy Gjeneratorëve në rrjet. Bazuar në matjet/ndikimet e simuluar për dy gjeneratorët ZRRë konstaton në rastin e parë dhe të dytë kemi furnizim brenda standardeve të parapara me Kodin e Rrjetit të OSSH, përkatësisht nenit 3.6.2.3 e ku thuhet se: OSSH do ta operojë Sistemin e Shpërndarjes ashtu që të sigurojë që tensioni nëpër terminalët e sistemit të furnizimit, siç është definuar në standardin IEC 50160 (pika 4.3.1 dhe 4.3.2), të përputhet me këtë standard. Toleranca e brezit të tensionit të nivelit të TM dhe $TU \pm 10\%$, në raste të veçanta +10, -15. Tensioni rezultues në pika të ndryshme në sistem varet nga disa faktorë, por në pikën lidhëse më të largët-teknikisht me konsumatorët mund të pritët të jetë në përputhje me të dhënat në tabelën në vijim, për kushte stabile dhe normale të operimit. Tensioni nominal për nivelin 10 kV është 10 kV ku toleranca e brezit luhatjes është: Tensioni maksimal (+10%) 11 kV, Tensioni minimal(-10%) 9 kV kurse për Tensionin Minimal (-15%) 8.5 kV. Në baze të kalkulimeve të dërguara vërehet se në asnjë rast nuk kemi tejkalim, pra ndikim në rritjen e mbi tensioneve përkundrazi kemi përmirësim të tensionit nga tensioni nominal pa kyçjen e Gjeneratorëve në daljen "Slivova" e cila në shumë raste është nën 10 kV.

Me datë 20.02.2024 KEDS ka ofruar sqarime shtesë në lidhje me ngarkesat në daljen "Slivova 1" si dhe nënstationin e KEDS NS 35/10kV Artana si dhe arsyen e mos dhënies së PEE për aplikuesin "Solar Energy Artana SEA" SHPK. Në sqarimet e dërguara theksohet se:

Pas analizimit të dhënave si:



Kapaciteti i instaluar i NS Artana, i cili është 4MVA;

Kapaciteti termik i "Dalja 10kV Slivova", i cili është 2.078 MW (Al/Fe 25mm²);

Ngarkesa mesatare e daljes në periudhën Qershor-Gusht e cila është 0.774 MW, dhe

Kapaciteti gjenerues i rezervuar nga Parku Solar "Slivova 1" prej 0.8MW;

Kapaciteti i kërkuar prej 0.495MW është refuzuar për arsye si më poshtë:

Ngarkesa mesatare gjatë periudhës Qershor-Gusht është 0.774MW, kurse fuqia gjeneruese në këtë periudhë do të arrij në $0.8\text{MW} + 0.495\text{MW} = 1.295\text{MW}$;

Totali i kapacitetit gjenerues në këtë dalje do të tejkaloj 60% të kapacitetit termik të lejuar të cilin KEDS e ka parapërcaktuar si vlerë për ngarkesë të linjës nga Gjeneratorët. Fuqia maksimale do të arrij $0.8\text{MW} + 0.495\text{MW} = 1.295\text{MW}$ e që korrespondon me vlerën prej 62% të vlerës së kapacitetit termik të lejuar të linjës; dhe

Totali i kapacitetit gjenerues në këtë dalje do të tejkaloj 30% të fuqisë së instaluar të nënstacionit, për arsye se $1.295\text{MW} = 32.37\%$ e 4MVA.

Kurse, sa i përket Pëlqimit Parimor, ky dokument nuk siguron kyçjen apo pikën e kyçjes. KEDS përmes këtij dokumenti vërteton vetëm një aspekt: Ndërtimi i objektit nuk e rrezikon infrastrukturën e KEDS duke përfshirë objektet energjetike dhe linjat e tensionit të mesëm dhe atij të ultë. KEDS po ashtu me date 13.03.2024 ka dërguar ne ZRRE te dhënat lidhur me profilin e ngarkesës së daljes 10 kV Slivova për vitin 2022 dhe 2023 përfshi edhe vetëm per periudhat Qershor-Korrik-Gusht. Këto te dhëna janë dërguar bazuar ne matjet 15 minutash te bëra ne njehsorin elektrik nr. 97830252 dhe sipas tyre vërtetohet se:

Ngarkesa mesatare per vitin 2022 ka qenë 764.08 kW, vetëm per periudhën 2022 Qershor-Gusht (ora: 07-19) 774.76 kW kurse ngarkesa maksimale per vitin 2022 ka qenë 1,534.20 kW dhe minimale 0.30 kW, kurse per vitin 2023 ngarkesa mesatare ka qenë 811.51 kW, vetëm per periudhën 2023 Qershor-Gusht (ora: 07-19) 833.03 kW, kurse ngarkesa maksimale ka qenë 1,405.80 kW dhe minimale 82.20 kW.

Bordi i ZRRE bazuar ne te gjitha analizat e bëra e ne veçanti ngarkesat ne daljen "Slivova" si dhe simulimet e bëra nga KEDS lidhur me devijimin e tensionit pas kyçje s se dy gjeneratorëve konstaton se KEDS është dashur qe te lëshoj Pëlqim Elektroenergjetik si dhe Zgjidhjen Teknike per aplikuesin "Solar Energy Artana SEA" SHPK duke marrë te gjitha masat e parapara me Kodin e Matjes si dhe Kodin e Rrjetit te OSSH per përcaktimin e kushteve (normave) teknike te parapara per kyç jen e aplikuesit(Gjeneratorit) për operim stabil dhe të sigurtë të Sistemit të Shpërndarjes. Po ashtu KEDS ka vepruar edhe ne kundërshtim me nenin 51, paragrafi 4 I Ligjit për Energjinë Elektrike e ku potencohet qarte kur refuzohet përkohësisht kyçja dhe atë vetëm kur pajisjet e konsumatorit nuk janë ne përputhje me kodet teknike, pra neni 51, paragrafi 4, potencon: "Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes mund ta refuzojë përkohësisht kyçjen e një konsumatori ose prodhuesi në sistem, nëse konstaton se pajisjet e konsumatorit apo të prodhuesit nuk plotësojnë normat teknike ose kushtet tjera të përshkruara në Kodin e rrjetit të transmetimit dhe Kodin e rrjetit të shpërndarjes. Gjithashtu neni 10 i Rregullës për Kushtet e Përgjithshme te Furnizimit me Energji përcakton se Operatori i Sistemit mund të refuzoj të kyçë një aplikues përkohësisht, vetëm nëse ajo kyçje nuk është në përputhje me dispozitat e Kodit të Rrjetit dhe Shpërndarjes ose kodeve tjera në fuqi. Gjithashtu neni 9, paragrafi 9.2.6 I Metodologjisë se Taksave per Kyçje te OSSH, përcakton se OSSH mund të refuzoj të kyçë një Aplikuesi përkohësisht, vetëm nëse ajo kyçje nuk është në përputhje me dispozitat e Ligjit për Energjinë Elektrike, Rregullës për Kushtet e Përgjithshme, Kodit të Rrjetit dhe Shpërndarjes ose kodeve tjera në fuqi.



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji pas analizave të bëra dëshmime dhe argumenteve të paraqitura nga palët e në kërkesën e konsumatorit për Pëlqimi elektroenergetik, përgjigja e KEDS nr. 10130 datë 08.11.2023, Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, Metodologjisë së taksave për kyçje të rrjetit të Shpërndarjes dhe Ligjin për Energji Elektrike LIGJI Nr. 05/L – 085, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimin të Vendimit ose nga data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Lutfije Dervishi, anëtare

Gani Buçaj, anëtar

Arta Isufi, Anëtare

Adnan Preniqi, Anëtar

Vendimi u dërgohet:

- KEDS,
- Aplikuesit: F.K, “Solar Energy Artana SEA” SHPK dhe
- Arkivit të ZRRE-së.